

PROTOKOLL

DELEGUIMI PËRGJITHSHME
DHE DOGANAVE
Nr. 45716 Prot.
Datë, më 01.07.2022

ndërmjet Ministrisë së Financave – Administratës Doganore të Republikës së Serbisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë – Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të Republikës së Shqipërisë në lidhje me zbatimin e marrëveshjes për njohjen e ndërsjellë të operatorëve ekonomikë të autorizuar – autorizimet për sigurinë dhe mbrojtjen (OEAS) ndërmjet Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Në përputhje me nenet 8 dhe 11 të marrëveshjes për njohjen e ndërsjellë të operatorëve ekonomikë të autorizuar – autorizimet për sigurinë dhe mbrojtjen (OEAS) ndërmjet Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nënshkruar më 21 dhjetor 2021 në Tiranë, Ministria e Financave – Administrata Doganore e Republikës së Serbisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e Republikës së Shqipërisë (në vijim referuar si “Palët”),
bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1
Dispozitat hyrëse

Ky Protokoll përcakton metodën e kryerjes së procesit të vleftësimit të njohjes së ndërsjellë të OEAS.

Neni 2
Ekipi i vleftësimit

Secila Palë i njofton Palës tjetër me shkrim anëtarët e ekipit të saj të vleftësimit. Ekipi i vleftësimit i secilës Pale përbëhet nga ekspertë të OEA, me nga tre anëtarë secili.

Neni 3
Procesi i vleftësimit

Palët bien dakord për datën ekzakte të fillimit të vleftësimit.

Përpara vizitës së planifikuar të ekipit të vleftësimit, Palët shkëmben në me njëra-tjetren dokumentacionin e plotë në lidhje me Programin e OEA në gjuhët zyrtare të Palëve dhe në gjuhën angleze. Dokumentacioni që duhet shkëmbyer përfshin: dispozitat e legjislacionit doganor në lidhje me OEA, dispozitat e akteve nënligjore përkatëse, shpjegime dhe udhëzime.

Përpara kryerjes së një vizite pranë një shoqërie, duhet të merret pëlgimi i shoqërisë përkatëse për vizitën e delegacionit të huaj.

Ekipet e vleftësimit do të vizitojnë dy shoqëri të pajisura me autorizimin e OEA.

Në vijim të vizitës do të hartohet një raport, ku anëtarët e ekipit do të jasin opinionet e tyre lidhur me programin e OEA, duke përfshirë gjykimin e tyre nëse programi është zbatuar në përputhje me kushtet e parashikuara.

Neni 4
Rezultatet e vlefshesimit

Për kërkeshat e këtij Protokollit, Palët bien dakord të njojin Raportin e Vlefshesimit (ë Njohjes së Ndërsjellë të OEAS për Programet e OEA dhe proceset e OEA, i cili është ekivalenjt me të njëjtin proces vlefshësi të kryer ndërmjet vetë Palëve, dhe është hartuar nga ekipi i vlefshesimit i emëruar nga Sekretariati i CEFTA).

Neni 5
Shkëmbimi i informacionit midis Palëve

Shkëmbimi i informacioneve të parashikuara në nenin 8 të marrëveshjes për njohjen e ndërsjellë të operatorëve ekonomikë të autorizuar – autorizimet për sigurinë dhe mbrojtjen (OEAS) ndërmjet Qeverisë së Republikës së Serbisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë bëhet çdo javë nëpërmjet Sistemit të Shkëmbimit Sistematik Elektronik të të Dhënave (SEED).

Neni 6
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij Protokollit do të zgjidhet, sipas rastit, në nivelin e ekipeve të vlefshesimit.

Mosmarrëveshjet për të cilat nuk arrihet një zgjidhje sipas mënyrës së parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni do t'u referohen autoriteteteve më të larta të secilës Pale.


Neni 7
Hyrja në fuqi dhe periudha e vlefshmërisë së Protokollit

Ky Protokoll hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të tij nga të dyja Palët.

Vlefshmëria e këtij Protokollit përfundon në datën kur të dyja Palët janë njoftuar për përfundimin e procesit të vlefshesimit.

NËNSHKRUAR në, më 1 shtator 2022, në dy kopje origjinale në gjuhën, shqipe, serbe dhe angleze, ku secili tekst ka të njëjtën vlerë ligjore. Në rast mosmarrëveshjesh në lidhje me interpretimin, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

për
Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë -
Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të
Republikës së Shqipërisë


Drejtor i Përgjithshëm
Genti Gazheli

për
Ministrinë e Financave –
Administratën Doganore
të Republikës së Serbisë


Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar
Branko Radujko